



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2882

NR. VENDIMI 5723

V E N D I M
" N Ë E M Ë R T Ë R E P U B L I K Ë S "

Gjykata e Rrethit Gjyqësore Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

Rezarta MATAJ ----- Gjyqtare

me sekretare seance Ina Serjanaj, në Tiranë, sot më datë 23 qershor 2017, ora 09:00, pasi mori në shqyrtim në disa seanca gjyqësore, me dyer të hapura çështjen civile që i përket :

Paditës: *** shoqëri spanjolle me seli ***, e përfaqësuar me prokurë të posaçme noteriale nga av. ***, antare e dhomës së Avokatëve ***.

I paditur: Shoqëria *** me NUIS *** me adresë në ***, me administrator ***, e përfaqësuar me prokurë të posaçme noteriale nga av. ***, antarë e Dhomës së Avokatisë ***.

Me person të tretë: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale e përfaqësuar nga juriste *** (e papranishme në shpallje). Avokatura e Shtetit Zyrën Vendore Tiranë (në mungesë)

Me objekt: Shfuqizimi dhe fshirja nga regjistri i markave tregtare të markes tregtare *** me numer regjistrimi *** për shkak se aplikimi i kesaj marke është bere ne keqbesim nga i padituri.

Baza ligjore: Neni 348 i Kodit të Proçel173 durës Civile dhe nenet 142, 143, 156, neni 173 të ligjit nr. 9947 datë 07 korrik 2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar.

-Në bisedimet përfundimtare palët kërkuar:

-Përfaqësuesja e palës paditëse : "Pranimin e kërkesë padisë, sipas objektit "

-Përfaqësuesja e palës së paditur : "Rrëzimin e padisë".

-Përfaqësuesja e personit të tretë DPPI kërkoi- «E lë në çmim të gjykatës».

-Gjykata pasi mbylli hetimin gjyqësori, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brëndshme

V Ë R Ë N s e

1. Paditësi është një shoqëri që vepron sipas ligjeve të Spanjës dhe prodhuese e çakmakëve me rimbushje dhe produkteteve të tjera për duhanpirës.

2. Shoqëria "****" shpk është krijuar si shoqëri tregtare me datë ***. Ka fushë të veprimtarisë së saj tregti me shumice e pakicë artikuj ushqimore dhe industriale, bujqësore,

import, eksport, transport mallrash dhe udhëtarësh etj.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar (më tej GJRRGJ Tiranë) sipas nenit 348 të Kodit të Proçedurës Civile (më tej KPRC) vlerëson se ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën tokësore dhe lëndore në gjykimin e kësaj kërkesë-padie pasi është seksioni tregtar i kësaj Gjykate e cila gjykon të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale për tërë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky qëndrim është i konsoliduar edhe nga praktika e Gjykatës së Lartë e cila pavarësisht se diskutohet për ankimum të vendimit të Drejtorisë së përgjithshme të Markave dhe Patentave (organ administrativ), duke qënë se kemi të bëjme me lënde të fushës tregtare si ajo e pronësisë intelektuale, parashikohet të gjykohet vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Tregtare.

4. Me ndryshimet e emërimit të personit të tretë sipas ligjit nr. 17/2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave në Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale u bë kalimi proçedural sipas nenit 199 të KPRC.

4. Pala paditëse ka të regjistruar ndërkombëtarisht në Zyrën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (ËIPO) duke përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, regjistrimin nr. *** markën «***» fjalë dhe figurë, ngjyrë e zezë dhe të verdhë. Kjo markë shërben për të dalluar mallrat e të Klasifikimit të Nicës 11 - çakmak, çakmak me gaz, çakmak për djegie gazi, djegës gazi), 34 - ndezje zjarri.

4.1 Rezulton sipas të dhënave të marra nga sistemi ndërkombëtar ROMARIN e sjellë nga personi i tretë se kjo markë është regjistruar në Shqipëri me datë 18.02.2016. Gjithësesi në momentin e aplikimit ndërkombëtarisht datë 18.12..2015 sipas Konventës së Madritit e ratifikuar nga Shqipëria që në 2003, ajo ka mbrojtje ligjore nga të gjitha zyrtat kombëtare të Markave, të shteteve antare.

5. Nga ana tjetër aplikimi i bërë nga i padituri është me datë 04.06.2015 (gjashtë muaj më parë), markë tredimensionale, ngjyrë e zezë, e kuqe dhe e verdhë për mallrat e klasifikimit të Nicës 4,8, 39 ku përjashtohet gazi buton me pesë 170 g.

6. Paditësi i kërkon gjykatës shfuqizimin e kësaj marke pasi është regjistruar me keqbesim, duke njohur karakterin ndërkombëtar të njohjes së kësaj marke e provuar me:

-1) fotografi të markës *** e vendosur në çakmak të ndryshëm në faqen zyrtare të ***. Eu (akses dhjetor 2016), 2)fatura tatimore të shitjes 2014-2016për të provuar importimin e këtyre çakmakëve nga personi fizik tregtar *** me NUIS *** dhe *** (emri tregtar ***) me NUIS *** me adresë në ***, për në Shqipëri që nga data 29.04.2014,21.11.2014, 07.04.2015, 15.02.2016, 12.07.2016, 3) fotografi të automjetit me fashë marketingu «***», çakmak dhe koli çakmakësh me shënimin *** publikuar faqen e Facebook të ***.

- Në gjykimin gjykata kqyri sende, çakmak me shënimin *** dhe ato të cilët pretendohen se nuk janë çakmak origjinal por që kanë formën njësoj si çakmakët ku shënohet marka ***, të cilat u sollën nga padiësja si të blerë në market ” *** bashkë me kuponin tatimor” në Shqipëri por pa ndonjë fletë origjine që janë të prodhuar a importuar nga ana e ***Shpk.

- me importin e këtij malli, çakmak me markën *** edhe në shtete të tjera si Itali për periudhat 2010-2014 sipas faturave të shitjes, Greqi për periudhat 2005-2012 sipas faturave të shitjes,

8. Gjykata kqyri online ekstratet historik të personave tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (qkb.gov.al) ku rezultoi se:

-***ka filluar veprimtarinë tregtar (import-ekpsort të artikujve të ndryshëm kozmetikë, kancelari, shitje derë më derë) në *** me emrin tregtar *** dhe tashmë është e pezulluar *** ;

- *** ka filluar veprimtarinë tregtar (import-ekpsort të artikujve të ndryshëm

kozmetikë, kancelari, shitje derë më derë) në *** me emrin tregar *** , me status aktiv.

9. Gjykata mori informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave rezultoi se *** dhe *** kanë importuar çakmak të markës *** për periudhën 2014-2017 vetëm tetë herë ne datat 22.05.2014, 19.12.2014,24.04.2015, 24.04.2015, 05.03.2016, 29.07.2016, 25.10.2016. Kompania exportues nuk del *** por *** ***, më pas *** dhe më pas *** .

10. Paditësi pretendoi se:

- çakmakët *** kanë kohë që janë futur në tregun shqiptar;
- i padituri ka pasur dijeni për këtë markë dhe me keqbesim duke parë numrin e lartë të shitjeve të tij ka regjistruar shenjën identike të saj ku stilizimi, sfondi, kuadrati është i njëjtë.
- mallrate të paditurit janë plotësuse dhe konkurruese me mallrat e paditësit në treg;
- mundësia e konfuzionit tek publiku është e paevitueshme;
- ka një përdorim të mëparshëm të kësaj marke që nga 2013 nga ***;
- produktet e paditësit janë të njohura në mbarë botën prandaj i padituri ka bërë regjistrimin e markës me keqbesim.

11. Pala e paditur prapësoi se:

- e gjithë procedura e regjistrimit dhe e mbrojtjes së markës së shoqërisë *** shpk është bërë sipas ligjit dhe në transparencë të plotë;
- shoqëria *** shpk është ajo e para që ka regjistruar markën tek DPPM-ja;
- në faturat e vitit 2014 të *** dhe *** është ajo që ka futur produktet në Shqipëri po nuk tregon se ka konsumim të gjërë;
- nuk rezulton sipas DPDoganave se importues të jetë ***.
- ekspozimi në facebook nuk është provë e mjaftueshme për prioritet;
- nuk kemi të bëjme me një markë të mëparshme dhe kjo palë po vepron me keqdashje duke kërkuar shfuqizimin e markës sonë.

12. **Person i tretë pretendoi se:** edhe pse u thirr gjatë gjykimit nuk u paraqit asnjë seancë.

III.Legjislacioni izbatueshëm

13. Ligji 9947 datë 07 korrik 2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar
PJESA IV -Markat tregtare dhe të shërbimit,
KREU XXIII - Kushtet dhe e drejta për mbrojtjen

Neni 140 “Shenjat që përbëjnë markë “

“1. Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

Mund të përbëjnë markë shenjat e mëposhtme:

fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. *Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto. “*

Neni 141 -Karakter i dallues

“Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre.

Karakter i dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t'i dallojë. “

Neni 173 – Shfuqizimi I markës

“1. Gjykata, me kërkesë të personit të interesuar, shfuqizon markën e regjistruar nëse:

- a) është regjistruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 142 e 143, të këtij ligji, në kohën kur është depozituar aplikimi për regjistrim;
 - b) aplikimi për regjistrimin e markës është bërë në keqbesim.
2. Çdo markë e regjistruar që shfuqizohet, vlerësohet si e paqenë, duke filluar nga data e depozitimit të markës. Kur marka, që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” ose “c” të pikës 1 të nenit 142 të këtij ligji, ka fituar karakter dallues, në përputhje me pikën 2 të nenit 142 të këtij ligji, nuk shfuqizohet, por data e prioritetit do të zhvendoset në kohë, kur marka e ka fituar karakterin dallues.
3. Një markë nuk mund të deklarohet e pavlefshme me arsyetimin se ekziston një markë e mëparshme, që është në konflikt me këtë markë, nëse marka e mëparshme nuk përmbush kërkesat e nenit 159 të këtij ligji. Nëse marka tregtare e mëparshme është përdorur vetëm për një pjesë të produkteve apo shërbimeve, për të cilat është regjistruar, konsiderohet se ajo është regjistruar vetëm për këtë pjesë produktesh apo shërbimesh.
 4. Kur arsyet për refuzimin e regjistrimit ose për deklarimin e shfuqizimit të një marke lidhen vetëm me disa mallra ose shërbime, për të cilat është paraqitur aplikimi apo është regjistruar marka, refuzimi i regjistrimit ose deklarimi i pavlefshmërisë mbulojnë vetëm ato mallra ose shërbime.
 5. Shfuqizimi i një marke të regjistruar nuk mund të bëhet pa u thirrur në gjykim pronari i saj. Gjykata njofton DPPM-në për vendimin për shfuqizimin e një marke.
 6. DPPM-ja regjistron vendimin për shfuqizimin e një marke në regjistrin e markave.”

Neni 142 - Refuzimi për shkaqe absolute

“1. Një shenjë nuk regjistrohët si markë nëse:

- a) nuk ka karakter dallues;
- b) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave apo të kryerjes së shërbimeve, ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave apo të shërbimeve;
- c) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që janë bërë të zakonshëm në gjuhën e përditshme apo që janë kthyer në praktika tregtare;
- ç) përbëhet nga forma ose vija, të imponuara nga vetë natyra e mallrave apo e shërbimeve dhe/ose forma apo linja thelbësore, për të përmbushur një rezultat teknik;
- d) përbëhet nga forma, që u japin mallrave një vlerë thelbësore;
- dh) përbëhet nga elemente, që cenojnë interesin publik ose që bien në kundërshtim me vlerat morale apo rendin publik;
- e) përbëhet nga elemente, që kanë prirje të çorientojnë publikun për natyrën, cilësinë, origjinën gjeografike të mallrave dhe/ose shërbimeve, që ato kanë për qëllim të dallojnë;
- ë) përbëhet nga tregues gjeografikë, për verërat ose pijet alkoolike, që nuk e kanë origjinën gjeografike nga vendet, që tregohen në këta tregues, edhe nëse tregohet origjina e vërtetë e produkteve, ose treguesit gjeografikë janë përkthyer apo shoqëruar me shprehje të tilla, si “lloji” “tipi” “stili” “imitimi” ose shprehje të ngjashme;
- g) përbëhet nga: i) emra shtetesh (të plotë ose të shkurtuar); ii) emblema shtetërore, medalje, urdhra nderi; iii) vula dhe shenja zyrtare të miratuara nga vendi; iv) emblemat e organizatave të njohura ndërkombëtare ose shkurtimet e tyre; v) simbolet fetare; vi) flamujt kombëtarë;
- gj) përbëhet nga elemente, që bien në kundërshtim me nenin 6 të Konventës së Parisit, përveç kur autoritetet kompetente kanë autorizuar përdorimin e tyre.

h) nuk përbën markë, sipas nenit 140 të këtij ligji;

i) përmban ose përbëhet nga një emërtim origjine ose një tregues gjeografik, me efekt në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse kërkesa për regjistrimin e markës është dorëzuar pas datës së dorëzimit të kërkesës për regjistrimin e emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik dhe me qëllim mbrojtjen e tyre, të parashikuar në legjislacionin, në bazë të të cilit janë regjistruar ato dhe që kanë lidhje me të njëjtin lloj produktesh.

2. Një shenjë nuk përjashtohet nga regjistrimi si markë, në përputhje me shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni, në qoftë se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues në procesin e përdorimit përpara datës së aplikimit. “

Neni 143 -Refuzimi për shkaqe relative

“ Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

1. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakimit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t'u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

- a) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;
- ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, te publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit. “

14. Neni 6 bis i KONVENTA E PARISIT PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INDUSTRIALE NGA 30 MARS I VITIT 1883, i amenduar

«1) Vendet e Unionit obligohen, qoftë sipas detyrës zyrtare, nëse e lejon legjislacioni i atij vendi, qoftë me kërkesë të palës së interesuar, të refuzojnë ose anulojnë regjistrim dhe ndalesë të përdorimit të shenjës fabrikimi ose tregtare që përfaqëson riprodhim, mbështetje ose përkthim, ashtu i realizuar që të mund të krijojë konfuzion me ndonjë shenjë që autoriteti përkatës i vendit të regjistrimit ose përdorimit do të konsideronte se në atë vend padyshim është i njohur si shenjë e personit që gëzon të drejtën për ta përdorur me këtë konventë dhe të përdoret në produkte të llojit të njëjtë ose të ngjashëm. Në të njëjtën mënyrë do të procedohet edhe nëse pjesa e rëndësishme e shenjës përfaqëson riprodhim të ndonjë shenje të tillë që padyshim është i njohur ...e mund të krijojë konfuzion me atë shenjë.

2) Një afat më i shkurtë, prej pesë viteve, duke llogaritur nga data e regjistrimit, duhet të jepet për kërkesë për fshirjen e shenjës së tillë. Vendet e Unionit mund të parashikojnë një afat në të cilin mund të kërkohet ndalesë përdorimi.

3) Nuk do të përcaktohet afat për kërkesë për fshirje ose ndalesë përdorimi të shenjave të regjistruara ose të përdorura me qëllim të keq.»

IV. Vlerësimi dhe analiza e çështjes sipas ligjit dhe provave

15. Që një markë të regjistrohet dhe të gjej mbrojtje pronari i tij për të gjitha të drejta e pronësisë sipas ligjit nr. 9947/2008 por edhe Konventës së Parisit 1883, duhet që:

1. marka tregtare të përbëhet nga shenja/at të cilët janë të mundshme për tu paraqitur grafikisht;

2. të ketë karakter identifikues, dallues të atij mallit dhe/ose shërbimit që tregon pronari i ardhëshëm(person fizik ose juridik). Dallimi duhet të jetë i tillë që të mos konfundohet nga çdo individ me intelekt mesatar, konsumator i zakonshëm. Dallueshmëria lidhet edhe me origjinën tregtare të mallit por edhe mallin a shërbimin që kërkon të dalloj.

3. Të plotësoj kushtet e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji.

- Neni 141 -Karakter i dallues;
- Të mos ketë shkaqe absolute refuzimi, kjo bën që të verifikohen kryesisht si nga aplikuesi por edhe nga autoriteti që regjistron markën sipas nenit 142 të ligjit;
- Të mos ketë shkaqe relative refuzimi që nënkupton se edhe nëse është regjistruar marka ajo mund të shfuqizohet për raste përkatëse të nenit 143 të ligjit.

16. Në rastin konkret, rezulton se paditësi është pronar i regjistruar në regjistrin e Zyrës Botërore të Pronësisë Intelektuale (ËIPO), e konkretisht për markën me nr. *** – *** që me datë 18.12.2015, fjalë dhe figure të verdhë dhe të zezë. Për Shqipërinë fillon mbrojtja me datë 18.2.2016 dhe ka kufizuar mbrojtien vetëm për mallrat e Klasifikimit të Nicës 34 (Artikujt e duhanpirësve; çakmak për duhanpirësit; Kontejnerët e gazit për çakmakët; Çakmakë xhepi për duhanpirësit, Kontenierë me gaz për çakmakët për duhanpirësit; Filtra të cigareve; gurë ndezës etj.

17. Kjo markë figuron e regjistruar edhe pranë DPPI sipas protokollit të Madridit që me datë 10.11.2016 por efektet i sjell nga data e depozitimit tek ËIPO me datë 18.12.2015.

18. Nga ana tjetër, pala e paditur *** shpk është pronare e markës nr. *** e regjistruar pranë

DPPI (ish -DPPM) që me datë depozitimi 04.06.2015, tre përmasore *** me ngjyra ngjyrë e zezë, ngjyrë e kuqe, ngjyrë e verdhë për mallrat e Klasifikimit të Nicës: **4** - Gaz(gaz i lëngshëm), **8** - Veglat e dorës dhe pajisjet që operohen me dorë; sprucues(sprayers) që përdoren me dorë për përdorim nga njerëzit, **39** - Shërbime të shpërndarjes dhe ambalazhimit të gazit ku ne me marrëveshjen e Madridit kemi marr pjesë.

19. Rezulton se me emrin *** në DPPI është e regjistruar marka edhe në disa raste të tjera nga pronar shoqëri Spanjolle, Italiane , Franceze etj. si psh marka *** për produkte farmaceutike me pronar ***.
20. Ashtu siç figuron në sistemin ROMARIN të kërkimit të markës *** fjalë dhe figurë por me ngjyrë, shkrim dhe produkte mbrojtëse të ndryshme, 45 marka. Të vetmet në ngjyrë të verdhë, me shkrim me shkronja kapitale *** dhe kombinim zezë, blu, kuqe etj. është pronare *** shoqëri Spanjolle, kryesisht për sende të duhanpirësve si çakmak.
21. Në mënyrë krahasimore i paraqesim të dy markat e regjistruar:

DETAJET E MARKËS SË PADITËSIT	DETAJET E MARKES SË TË PADITUR

Detajet e Markes

Detajet e Markes			
(210) Nr. i kërkeses:	***		
Tipi i aplikimit:	Madrid Protocol		
Lloji i markes:	Fjalë dhe Figure		
(540) Marka:			
(591) Ngjyrat që Mbrohen:	Yelloë and black.		
(531) Klasifikimi i Vienës:	26.4.7 - Tëo quadrilaterals, one inside the other 26.4.18 - *Quadrilaterals containing one or more letters 29.1.12 - Tëo predominant colours		
(511) Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve:	11 - Lighters; gas lighters; lighters for igniting gas; gas burners. 34 - Smokers' articles; lighters for smokers; gas containers for lighters; pocket lighters for smokers; gas containers for lighters for smokers; cigarette filters; cigarette tips; cigarette paper; books of cigarette papers; firestones.		
(732) Pronari:	Emri	Adresa	Shteti
(210) Nr. i kërkeses:	***		
Tipi i aplikimit:	Goods and Services mark		
Lloji i markes:	Marke tre-permasore		
(540) Marka:			
(591) Ngjyrat që Mbrohen:	ngjyrë e zezë, ngjyrë e kuqe, ngjyrë e verdhë		
(531) Klasifikimi i Vienës:	19.3.1 - Small cylindrical or elliptical containers (such as tubes for pills or for lipsticks, pots for cosmetic cream, preserve tins, jars, cans) 27.5.11 - *Letters underlined, overlined, framed or barred by one or more strokes 29.1.13 - Three predominant colours		
(511) Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve:	4 - Gaz(gaz i lëngshëm) 8 - Veglat e dorës dhe pajisjet që operohen me dorë; sprucues(sprayers)		

	***	***	ES
Dt.depozitimit:	18.12.2015		
Statusi:	E regjistruar		
Nr.regjistrimit:	***		
Dt.regjistrimit:	10.11.2016		
(220) Data e depozitimit:	18.12.2015		
(180) Data e mbarimit te mbrojtjes:	18.12.2025		
(740) Perfaqësuesi i Autorizuar:	Emri	Adresa	Shteti
	***	***	ES
(526) Elementët që përjashtohen nga mbrojtja:			
<i>Të dhëna të marrë nga faqja elektronike e DPPI.</i>			
	që përdoren me dorë për përdorim nga njerëzit 39 - Shërbime të shpërndarjes dhe ambalazhimit të gazit		
(732) Pronari:		Adresa	Shteti
	***	***	AL
Dt.depozitimit:	04.06.2015		
Statusi:			
Nr.regjistrimit:	***		
Dt.regjistrimit:	10.06.2016		
(220) Data e depozitimit:	04.06.2015		
(180) Data e mbarimit te mbrojtjes:	04.06.2025		
(740) Perfaqësuesi i Autorizuar:	Emri	Adresa	Shteti
	***	***	AL
(526) Elementët që përjashtohen nga mbrojtja:	butane gas; 250+50mg; Ëeight; 170g.		

22. Për analizuar kushtet e shfuqizimit të markës duhet të plotësohen kumulativisht këto kushte:

- të dy palët ndërgjyqëse paditës, I paditur janë pronar të markave të regjistruara në regjistrë kombëtare të markave ose atë ndërkombëtar sipas Konventës/Protokollit të Madridit;
- Marka e palës së paditur duhet të jetë e rregjistruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 142 e 143, të këtij ligji, në kohën kur është depozituar aplikimi për regjistrim dhe/ose në keqbesim;
- Nëse ajo deklarohet e pavlefshme relativisht për shkak të ekzistencës së një marke të mëparshme, kjo e fundit duhet të përmbush detyrimisht kriteret e parashikuar nga neni 159 të ligjit “Për pronësinë industriale” i ndryshuar.

23. Pasojat – pasi gjykata vendos shfuqizimin e markës për shkaqe absolute/relative dhe/ose në keqbesim vlerësohet marka tregtare si e paqënë dhe/ose, zhvendos datën e prioritetit dhe/ose kufizon shfuqizimin ose datën e prioritetit ose deklarimin e pavlefshmërisë vetëm për ato mallra ose shërbime të mallrave sipas sistemit të Nices që nuk prekin njëra-tjetrën.

24. **Së pari** - Në rastin konkret, marka tregtare *** me pronar *** e është një një markë të mëparshme në kuptim të nenit 143 §5 shkronja “ç”. Konkretisht u provua se *** që nga viti 2014 importon çakmak të markës *** nga Spanja, nga një subjekt tregtar spanjoll në adresë të njëjtë si ajo e paditësit pra ***.

25. Pa qënë e nevojshme të dihet emri i pronarit të markës, i padituri ka ditur mjaft

mire emrin e marëks së mallit të importuar, ***. Fakti i njohjes nga publiku i sektorit përkatës siç është edhe *** shpk (objekti i veprimtarisë së tij është edhe tregtimi i gazit), pra i subjekteve që merren me tregtimin e sendeve që mbushen me gaz, ambalazhojnë gaz, sendet që përdoren nga duhanpirësit për ndezje etj. për këtë markë dhe mallrat që ajo dallon është evidente, koha e gjatë e ndodhjes së këtyre mallrave me emrin *** në Shqipëri që nga 2014 ndërsa në shtete fqinjë që nga 2005 Greqi dhe Itali që nga 2010 ka bërë që kjo markë të jetë e mirënjohur dhe të konsiderohet markë e mëparshme.

26. **Së dyti** – Sipas nenit 143 §2 shkronja “b” e ligjit nr. 9947/2008 marka nëse është regjistruar konsiderohet e pavlefshme dhe shfuqizohet nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

27. Rezulton se marka e mëparshme e ***, *** është identike në fonetikë, vizualisht, ngjyra, stilizim të Shkronjave Kapitale me markën *** të *** shpk. Po ashtu, pavarësisht se njëra është tredimensionale tjetra fjalë e figure dhe mbrojnë kategori mallrash të ndryshme pra *** I *** shpk mallra të kategorisë 4, 8, 39 dhe *** I *** mallra të kategorisë 34 themi se këto janë veprime me keqbesim të të paditurit që duke e ditur shumë mire që po imiton një markë të mirënjohur të mëparshme, ka tentuar të përdor ato hapsirë ligjore që të mos paraqitet në regjistrim pranë DPPM si një kopjim I një marke tjetër. Por po të vihet re me sy të lire, mallrat që kërkohen të mbrojnë marka e ***shpk janë klasa të përgjithshme të cilët në fund të çojnë në plotësim të mallrave të klasës së Nicës nr. 34 pra kanë të bëjnë me gazin, mbushjen e tij, tregtim a ambalazhim, pra kemi të bëjmë me mallrat të ngjashme.

- Emri I markës është identike në ngjyrë, stilizim dhe fonetikë.

- Sipas nenit 142 marka tredimensionale për atë lloj marke nuk duhet regjistrohet pasi forma që ka ajo patjetër do të ishte e tillë për të përmbushur një rezultat teknik.

28. **Së treti** - Sipas nenit 173 të ligjit nr. 9947/2008 gjykata duhet të shfuqizoj markën *** të *** shpk pasi nuk përmbush kërkesat e neneve 142 e 143 të këtij ligji, në kohën kur është depozituar aplikimi për regjistrim. Pavarësisht se kemi klasa të ndryshme të mallrave që mbrohen sipas konventës së Nicës ajo duhet të shfuqizohet tërësisht për shkak të keqbesimit, konfondimit të konsumatorit dhe faktit se klasat janë plotësues të njëra-tjetrës dhe lidhet prodhimi i atyre mallrave me prodhuesin e çakmakëve *** të ***.

29. Si përfundim, padia e paditësit është e mbështetur në ligj dhe në prova.

IV. Mbi shpenzimet gjyqësore

30. Sipas nenit 106 të KPRC parashikohet se shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata kur provohet se janë paguar nga paditësi. Pra paditësi që të këtë rimbursim për shpenzimet gjyqësor si: Taksat mbi aktet, akt ekseptimi, shpenzim për dëshmitarë, noterizim provash, prokurë e posaçme noteriale, fotokopje, kancelari etj., shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë duhet t'i provojë me mandate bankare apo me kupon tatimor se i ka kryer këto shpenzime.

31. Në rastin konkret, padia është rrëzuar dhe shpenzimet mbulohen nga pala gjyqëmbësore/paditësi për aq sa provohen si të kryera me pulla takes gjyqësore, noteriale etj. Në rastin e faturës tatimore të shitjes nr. ***/16.06.2017 gjykata nuk e njeh si shpenzim të kryer sipas nenit 106 të KPRC pasi ajo nuk është nënshkruar nga blerësi, nuk është bërë pagesa akoma nga paditësi dhe nuk është paraqitet si zë I kryer por që do të kryehet në të ardhmen (mungon kupon tatimor apo transakcion banker që provon pagesën sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” 2008) dhe nuk është llogaritur TVSH-ja.

32. Po ashtu, në këtë gjykim për njoftimet gjyqësore, në masën *** lekë/fletëthirrja, janë parapaguar nga Gjykata të cilët do i ngarkohen palës gjyqëmbësore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 142, 143, 159, 173 të ligjit nr. 9947/2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, neni 6 bis i Konventës së Parisit dhe nenet 102, 106-310/1, 126 të Kodit të Proedurës Civile

PËR KËTO ARSYE

1. Pranimin e padisë së paditësit *** si e mbështetur në ligj dhe në prova.
2. Shfuqizimin e Markës ***** (tri dimensionale) me pronarë *** shpk e regjistruar në Shqipëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (Ish-DPPM) me datë 16.06.2016, datë depozitim aplikimi 04.06.2015 pasi është markë e ngjashme në emërtim dhe në mallra me markën e mëparshme nr. *** – *** (fjalë dhe figurë) të pronarit ***, e regjistruar pranë Zyrës Botërore të Pronësisë Intelektuale, me date 10.11.2016 e depozituar aplikimi me date 18.12.2015 dhe për Shqipërinë me date 18.02.2016.
3. Një kopje e këtij vendimi I dërgohet DPPI për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin e markave.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngrarim të palës së paditur.
5. Kundër këtij vendimi lejoheta nkaim në Gjykatën e APelit Tiranë Brënda 15 ditëve nga nesërmsja e shpalljes së këtij vendimi. Për Avokaturën e Shtetit në mungesë dhe Drejtorinë E Përgjithshme të Pronësisë Industriale e papranishme në shpallje ky afat I fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me date 23 qershor 2017 !

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

Ina Serjanaj

Dr. Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORE
(Sipas neneve 102 dhe 106 të K. Pr. Civile)

Taksë regjistrimi	*** Lekë
Taksë aktesh noteriale	*** Lekë
Për njoftime	*** Lekë

Sekretarja Gjyqësore

Ina Serjanaj